

PETICION

Drejtar: **Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).**
Komisionerit Publik.

Të nderuar, këshilltarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit!

Të nderuar Komisionerë!

Ne, avokatët dhe juristët e rrethit gjyqësor Vlorë, duke ju përgëzuar paraprakisht për punën e vështirë dhe delikate që jeni duke kryer gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve, ju drejtohami nëpërmjet kësaj shkresë me respekt dhe përulje për të parashtruar një shqetësim serioz për komunitetin tonë.

Kemi ndjekur me vëmendje të veçantë, procesin e rivlerësimit të magjistratëve, pasi jemi drejtëpërdrejtë të interesuar dhe kemi shpresuar se pavarësisht sfidave dhe kolapsit që po kalon sistemi i drejtësisë, rezultati përfundimtar do të jetë një drejtësi e re dhe e pavarur me magjistratë profesionistë dhe me integritet.

Kemi ndjekur me interes çdo rekomandim të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, pasi kemi vlerësuar se kjo strukturë i vjen në ndihmë këtij procesi delikat me sygjerime, këshilla dhe rekomandime të bazuara në principet më të larta të moralit, etikës dhe ligjit. E kemi parë këtë strukturë ndërkombëtare si garantuesin më të besueshëm të këtij procesi.

Megjithatë, bashkërisht, kemi çmuar t'ju bëjmë me dije se pasi jemi njojur me rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit për magjistraten Atalanta Zeqiraj, jemi të habitur dhe njëkohësisht thellësisht të indinjuar.

Znj. Zeqiraj punon prej disa vitesh në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe e themi me bindje se për komunitetin tonë, kjo gjë është privilegj.

Etika e komunikimit, integriteti profesional dhe humanizmi i saj, kemi menduar se përsaqësojnë më së mirë atë figurë të magjistratit që synon të përvijojë procesi i rivlerësimit.

Ju kërkojmë ndjesë për ngjyrimin emocional që mund të marrë ky komunikim, por vlerësojmë t'ju bëjmë me dije se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të magjistrates Atalanta Zeqiraj u përcoll me entuziazëm mes nesh dhe komunitetit të qytetit të Vlorës, komunitet i cili për shkak të specifikës, është ai që të jep i pari vlerësimin.

Duke rekomanduar që vendimi për këtë magjistrate të ankimojet, sigurisht pa dashjen tuaj ju keni vënë në dyshim jo vetëm integritetin e saj, por njëkohësisht perceptimin qytetar në efektshmërinë e procesit të rivlerësimit. Nëse ngrihen pikëpyetje mbi magjistratë të tillë të cilët përfaqësojnë shpresën tek drejtësia e pavarur, e paanshme, e pakorruptuar dhe njerëzore, nuk jemi në gjendje të përfytyrojmë cilësi të tjera që duhet të ketë një magjistrat për të qënë i konfirmuar në detyrë.

Zotërinj të nderuar përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Gjykata e Vlorës për shkak të karakteristikave dhe historikut të qytetit është një gjykatë në të cilën përballen një numër i konsiderueshëm qytetarësh që gjijnë zgjidhje ose që u përplaset një derë në ftyrë "në emër të ligjit".

Këta qytetarë dhe ne që i përfaqësojmë ose punojmë me ta jemi në gjendje të vlerësojmë punën dhe integritetin e gjithësecilit zyrtar e magjistrat.

Rekomandimi juaj i fundit për znj. Zeqiraj, e themi me keqardhje, nuk është në koherencë me vlerësimin dhe perceptimin e komunitetit të juristëve të këtij qyteti dhe më gjerë. Ky fakt për fat të keq ka ulur në mënyrë të ndjeshme pritshmëritë për rolin Tuaj dhe ka demotivuar çdo punonjës të drejtësisë në këtë qytet.

Ne vlerësuam që këtë fakt t'jua bëjmë me dije, të bindur që përfundimi juaj në lidhje me këtë rast mund të jetë pasojë e ndonjë keqkuptimi gjatë përcjelljes së informacionit të çështjes së saj.

Ne jemi qytetarë të një vendi që prej vitesh vuan nga tranzicioni dhe në të tilla kushte jemi të lodhur me përballjen me zyrtarë joprofesionistë dhe arrogantë që nuk dihet (ose dihet) se si kanë rastisur të përfaqësojnë një zyrë apo një institucion. Për pasojë çmojmë se na del për detyrë t'i mbrojmë dhe t'i kemi mes nesh profesionistët e ndershëm, të guximshëm dhe njerëzorë.

1 - Durim Beqiraj
Edhemet Ademi

Ar. Soko' Kamberi ~~Forensic 21~~

Ar. Genci Polaj ~~21~~

Ar. Esli Jhimjami ~~21~~

Ar. Remato Memetaj ~~21~~

Ar. Milema Musini ~~21~~

Ar. Drama Bone ~~21~~

Ar. Elvin Thauai ~~21~~

Ar. Zhelita Moltzak ~~21~~

Ar. Entlerida Miltza ~~21~~

Ar. Trisa Vizai ~~21~~

Ar. Agan ~~21~~

AV Record ~~21~~

AV florina ~~21~~

Psichologe. Drunka ~~21~~
Ar. Antoneta Tong ~~21~~

AV. Romario Memetaj ~~21~~

Ar. Frost Zefiq ~~21~~

Ar. Haxhi Miftu ~~21~~

Ar. Genci Hoxha ~~21~~

Ar. Megjen Thava ~~21~~

Ar. Lulzim Bajraktar ~~21~~

Av. Presidente -

Av. Ferdinand Bragaing -

Noter. Haiming Keklo

As. Noter Skender Khindi

Av. Vrseu Lolo Orata

Av. Ermal Prifti

Av. Biubic Moskoj

Av. Admet Dolor

Av. Gestion Pepeko

Av. Ylli Hysaj

Av. Gjergj Zogu

Av. Tefisit Muhamedev

Av. Anta Alcaq

Av. Armando Caproni

Av. Agim Ayri

Elspete Flora Tziraj

ing. Aida Kedli

Av. Kaliq Haxhi

Av. Enise Miftaraj

Av. Julian Begine

Fv. Skrajole ~~deane~~





Av. Xhoana Gelmanoj ~~Geluffi~~

Av. Soael Zafar ~~Fauzy~~


Ace. Youid Myslimi ~~g~~

Av. Entlerigle Nyle

Ar. FSI Jhimojami 


Av. Albany Shkodra 

Av. Agron Hoxha 

Av. Anton Kosej 

Av. Sead & Host 

Av. Agron Tozaj Jr.

AV Geran Genlavadhi  Gru

Av. Redi dlonoj  Mu

Mr. Ferdinand Rosner 

Psikologe. KLAUDINA HODA 

dr. Ayda 